



U R D H Ë R

Nr.44, datë 12.02.2019

P Ë R

CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE PËR DIASPORËN SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit të Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi, si koordinator shtetëror për ndjekjen dhe organizimin e programit vjetor të aktiviteteve shtetërore në interes të diasporës shqiptare dhe “Ditët e Shqipërisë”, për zbatimin e masës 45, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë e organizojë aktivitete në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar.
3. Për këtë proces koordinatori shtetëror të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA